



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA | REPUBLIC OF KOSOVO  
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT  
AGENCIJA ZA SPRJEČAVANJE KORUPCIJE  
THE AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT  
AGENCIJA ZA SPRJEČAVANJE KORUPCIJE  
AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION

Dep. DPKI  
Nr. Prot. 06-01/4852/22  
Br. Prot.  
Pr. No.  
Nri. Fiq. 02  
Er. Str.  
Ny. Page.  
Date 16.12.2022

LABORAMUS ETHICUM  
SINE CORRUPTIONE

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5, nenit 11 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1, nenit 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, lidhur me nenin 29, paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-017, për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 14.12.2022, nxjerrë këtë:

## V E N D I M

- I. Mbyllet rasti **AKK-DPKI-06-1225/22**, për zyrtarin e lartë z. **Skender Halili**, për shkak së është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Pas pranimit të informacionit të jashtëm nën dyshimin për konflikt të interesit në ushtrimin e funksionit publik, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka hapur rastin me numër protokolli **AKK-DPKI-06-1225/22**, për zyrtarin e lartë z. **Skender Halili**, kryesues i Bordit Mbikëqyrës të Autoritetit të Aviacionit Civil (në vijim: **BMAAC**), duke zhvilluar procedurën e paraparë sipas Ligjit nr.06/L-01 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në tekstin e mëtutjeshëm: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka filluar trajtimin e këtij rasti lidhur me pretendimet për konflikt të interesit, duke bërë fillimisht verifikimin dhe konfirmimin e këtij informacioni në institucionet përkatëse prej nga rezulton se z. **Skender Halili**, krahas ushtrimit të funksionit publik në cilësinë e Kryesuesit të **BMAAC**-së, njëkohësisht mbani funksionin e Drejtorit dhe/ose Përfaqësuesit të Autorizuar në Organizatat jo-qeveritare “**KS-Kosova**”, “**Solutions-Training and Development**”, “**the Norwegian Association of Local and Regional Authorities**”, si dhe në bizneset private “**DSF-Consultancy Training and Development**” **SH.P.K.** dhe “**Burim Halili**” **B.I.**

Ushtrimi i funksionit publik (kryesues i **BMAAC**-së) në cilësinë e zyrtarit të lartë, duke qenë njëkohësisht drejtor dhe/ose përfaqësues i autorizuar në **OJQ**-të dhe bizneset private të përmendura mësipër, paraqet gjendje të papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, siç përcaktohet me nenin 13, paragrafi 1 i Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, i cili përcakton se:

*“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit”,*

si dhe nenin 14, paragrafi 1, i cili përcakton se:

*“Zyrtari i lartë mund të jetë anëtar i organit drejtues, me përjashtim të funksionit drejtues, të organizatës joqeveritare nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës, veprimtarive humanitar e dhe të ngjashme pa të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe të tjera të lidhura me to”.*

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, përmes shkresës zyrtare (AKK-DPKI-06-1/1343/22), fillimisht ka njoftuar palën për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit. Më pas, me kërkesën e tij, është realizuar një takim brenda Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, ku janë ballafaquar të gjitha faktet, provat dhe informatat relevante lidhur me rastin në fjalë. Pas diskutimit dhe ballafaqimit të fakteve, z. Halili është pajtuar me gjetjet e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, duke deklaruar se do të ndërmer veprime të nevojshme në mënyrë që të shmanget papajtueshmëria në ushtrimin e funksionit publik.

Në ndërkohë, pala është njoftuar edhe njëherë me shkrim se në rast se nuk ndërmer veprime konkrete për shmangien e gjendjes së papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, atëherë Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit konform dispozitave përkatëse të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, do të procedohet pa vonesë me ‘Njoftimin paralajmërues për konstatimin e konfliktit të interesit’.

Mëpas, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka qenë e obliguar të veproj në pajtim me dispozitatat përkatëse të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, duke i dërguar palës ‘Njoftim paralajmërues për konstatimin e konfliktit të interesit’. Brenda afateve ligjore dhe konform nenit 19, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4 të Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, z. Halili (përmes shkresës zyrtare) ka njoftuar Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit se është tërhequr nga funksioni i Drejtorit dhe/ose Përfaqësuesit të Autorizuar në Organizatat joqeveritare “KS-Kosova”, “Solutions-Training and Development”, si dhe në bizneset private “DSF-Consultancy Training and Development” SH.P.K. dhe “Burim Halili” B.I., ndërsa në OJQ-në “the Norwegian Association of Local and Regional Authorities” nuk mban funksion drejtues.

Me ndryshimet e bëra nga z. Skender Halili në OJQ-të dhe bizneset private të sipërpërmendura, janë krijuar rrethana të reja me çfarë është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë.

Prandaj, në bazë të asaj që u tha më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**II.** Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11, të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, lidhur me nenin 29 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Agjencia mund të rihapë rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Me respekt!

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik,
- Drejtorit të DPKI-së,
- Zyrtarit përgjegjës



Ylli Buleshkaj  
Drejtore i Agjencisë  
për Parandalimin e Korrupsionit

